



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria – Vlada - Government**

*Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës – Ministarstvo Inostranih Poslova i Diaspora*  
*Ministër of Foreign Affairs and Diaspora*

*Datë: 27.05.2024*

**FTESË APLIKIMI PËR ANËTARË TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR  
PROJEKTPROPOZIMET**

Bazuar në thirrjen e shpallur më datë 24/05/2024 për projekt propozime për mbështetjen dhe financimin e OJQ-ve për veprimtari dhe angazhim në kuadër të diplomacisë publike, në nenin 8 pika 3.2 të Rregullores MF-NR-04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës fton organizatat jo qeveritare/shoqërinë civile/njohësit e diplomacisë publike dhe fushave: art, kulturë dhe sport, të aplikojnë për pjesëmarrje në komisionin e vlerësimit të projekteve:

- 1. përfaqësues nga OJQ-të** (një anëtar);
- 2. ekspert në vlerësimin e projekteve** (një anëtar).

Përfaqësuesit e lartcekur do të jenë anëtarë të komisionit për vlerësimin e projekt propozimeve të organizatave joqeveritare (OJQ) në fushën e diplomacisë publike, të pranuar nga MPJD, sipas thirrjes publike, e shpallur më 24.05.2024.

**Të drejtë aplikimi kanë:**

1. Të punësuarit në organizatat jo-qeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
2. Njohës të fushave të artit, kulturës, dhe sportit;

**Të interesuarit për aplikim për anëtar të komisionit duhet t'i plotësojnë kërkesat e përgjithshme të ftesës publike:**

1. të kenë përvojë në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të financuara nga burimet publike;
2. të kenë përvojë në vlerësimin e kërkesave të paraqitura në thirrjet për mbështetje financiare nga burimet publike;

3. t'i njohin dokumentet strategjike dhe politikat në fushën e diplomacisë publike;
4. t'a njohin bazën ligjore në fuqi në fushat që mbulon ftesa publike;
5. t'i njohin metodologjitë vlerësuese në komisione të ngjashme;
6. të kenë njohuri rreth dokumenteve të tjera relevante në fushën, për të cilën është hapur ftesa publike;
7. njohje e legjislacionit në fushën e mbështetjes financiare;
8. të mos jenë të emëruar politik, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Periudha e angazhimit do të jetë sipas afateve kohore të përcaktuara në Rregulloren MF – nr.-04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

Pagesa do të jetë 430 euro për anëtar.

**Afati për aplikim është 5 ditë, nga data 27.05.2024 deri më 31.05.2024, në orën 16.00.**

CV-të duhet të dërgohen në e-mail adresën: [ddp.mpjd@rks-gov.net](mailto:ddp.mpjd@rks-gov.net) - në subjekt të shkruhet **pozita për anëtar të komisionit, për të cilën aplikoni.**

*Aplikoj si përfaqësues nga OJQ-të  
apo  
Aplikoj si ekspert në vlerësimin e projekteve*

***Me respekt,  
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës***